



Nr. 22/1 prot
Shkollën 14/06/18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 17 Datë 07.03.2018

PËR MOSMIRATIM NË PARIM TË KËRKESËS PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE SUBJEKTIT "SEMAN SUNPOWER" SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, " Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni", për paisjen me autorizim(miratim në parim) të subjektit "SEMAN SUNPOWER" sh.p.k., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit "SEMAN SUNPOWER" sh.p.k., me administrator Z.Sadik LLAPASHTICA, për përdorim të burimit ujor **Lumi i Cemit**, për prodhim energjie elektrike (HEC PESHTAN), në Tamarë, Njësia Administrative Kelmend , Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.

2- Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyt e mëposhtme:

-Në Lumin e Cemit jetojnë dy specie të troftës (trofta e malit dhe trofta e Cemit) të përfshira në listën e kuqe me një status VU (i përkeqësuar). Ndërtimi i hidrocentralit do të shkatëronte dhe izolonte lëvizjen e lirë të specjeve ujore në këtë lumë.

-Shkatërron mjedisin dhe turizmin

-Vështirësonte jetën sociale dhe ekonomike të banorëve.

-Ndikim negativ në zhvillimin e lojrave të kanotazhit.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLJA

